



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/01-52992 dt. 31/10/2024



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenin 2 të ligjit nr.03/L-049 për financat e pushtetit lokal, nenit 27 të LMFP nr. 03/L-048, nenit 9, paragrafët 6,7 të ligjit nr.08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024. Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 31.10.2024, miratoi këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR.02-400/01-45467 TË DT.13/09/2024
PËR RITJEN DHE BARTJËN E TË HYRAVE VETANAKE

Neni 1

Me këtë vendim, plotësohet/ndryshohet vendimi nr.02-400/01-45467 i dt. 13/09/2024 për miratimin e rritjes dhe bartjes së të hyrave vetanake nga viti 2023 në vitin 2024. Mjetet për rritje dhe bartje, janë të hyrat vetanake të realizuara mbi planifikim.

Neni 2

Plotësim/ndryshimet që do të bëhen janë:

Neni 2 i vendimit 02-400/01-45467 i dt. 13/09/2024, do të jetë si në vijim: Të hyrat vetanake për rritje janë në shumë prej: **602,362.82 euro**, të cilat janë realizuar mbi planifikimin. Kjo shumë e të hyrave vetanake me rritje të bartën nga fondi (21) në fondin burimor (22) në shumë prej: **602,362.82 euro**.

Neni 3 i vendimit 02-400/01-45467 i dt. 13/09/2024, do të jetë si në vijim:

Totali i mjeteve për rritje dhe bartje, në shumë prej: **602,362.82 euro** barten në këto kategori ekonomike:

Mallra dhe Shërbime	13,094.00 €
Investime Kapitale	589,268.82 €
Totali i të hyrave për rritje dhe bartje nga viti 2023 në vitin 2024:.....	602,362.82 €

Neni 5 i vendimit 02-400/01-45467 i dt. 13/09/2024, do të jetë si në vijim:

Në kategorinë e shpenzimeve Kapitale në nën programet dhe projektet si vijon:

Infrastruktura Publike (18161) në projektet :

-Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellsit në Drenas, me nr.të proj. (48661) në vlerën prej:.....448,697.78 €
-Ndërtimi i parkut dhe shtigjeve për këmbësor, biçiklist, në parkun e Kamenicë Drenas me numer të projektit (52310) në vlerën.....62,150.00€

-Asfaltimi i rrugës në fshatin Poklek i Vjetër i Ri dhe Vasilevë nr.proj. (48635) në vlerën prej:.....25,327.28€

Shërbimet Kulturore (85001) në projektin:

-Fusha sportive dhe rekreacion Arllat, Llapushnik me nr.të projekti (54014) në vlerë prej:.....53,093.76€

Totali për rritje dhe bartje nga Invest. Kapitale nga viti 2023 në vitin 2024 në vlerë prej:.....589,268.82€

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Pjesa tjetër e vendimit nr.02-400/01-45467 të dt.13/09/2024 për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake mbetet i pandryshuar.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrani

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

Arsyetim

Ky propozim për plotësim-ndryshim të vendimit 02-400/01-45467 i dt. 13/09/2024, për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake. Rritja e të hyrave vetanake të korigjohet nga shuma prej: 627.362.82 euro, në shumë prej: **602,362.82** euro. Si rezultatë së shuma prej: **25,000.00€** e kategorisë rezerva e cila i takon vitit 2023, është bartur në vitin 2024 nga **MFPT** sipas strukturës të vitit paraprak. Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2023, në shumë prej: **2,159,378.00€** ku gjatë vitit fiskal janë realizuar mbi planifikim, dhe tejkalimin i të hyrave vetanake për vitin **2023**, është me shumen prej: **2,761,740.82€**, që keto mjete (rritja) të barten dhe do të perdoren për zhvillimin e projekteve të parapara për vitin **2024**.